

BACHELOR NË “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ky program ka për qëllim të përgatisë specialistë të aftë të realizojnë plotësimin e kërkesave teknologjike të lidhura me përpunimin, ruajtjen dhe komunikimin e informacionit midis kompjuterave, pajisjeve mobile ose pajisjeve të tjera elektronike. Ky program i përgatit studentët për të përballuar kërkesat e domosdoshme, lokale e ndërkombëtare, të paraqitura nga Teknologjia e Informacionit, si një fushë që kërkon menaxhim të sigurtë të një fluksi të madh të informacionit, si dhe aksesimin e sigurt të tij përmes sistemeve të ndryshme.

Mbajtësi i diplomës ka aftësi të mira programimi në disa gjuhë programimi, në bazat e të dhënave, në dizajnimin e faqeve web, aplikacioneve mobile e aplikime të tjera të teknologjisë së informacionit të përdorura në kompani, rrjeta kompjuterike, inxhinieri softweri etj.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të programit të studimit studenti është i aftë të:

- Ndërtojë dhe mirëmbajë rrjete kompjuterike.
- Dizenjojë dhe zhvillojë aplikacione duke përdorur gjuhë të ndryshme programimi.
- Organizojë infrastrukturën kompjuterike në mënyrë efektive.
- Zhvillojë dhe mirëmbajë bazat e të dhënave.
- Identifikojë zgjidhjet më të mira të softuerit dhe harduerit.

PROFILI: HARTIM SOFTWARE

- Dizenjojë, menaxhojë dhe mirëmbajë programet kompjuterike.
- Zhvillojë dhe mirëmbajë bazat e të dhënave.
- Menaxhojë sigurinë në sistemet e informacionit.

PROFILI: GRAFIKË DIZAJN

- Dizenjojë ndërfaqe grafike të përdoruesit.
- Aplikojë njohuri mbi kompozimin vizual, programet e dizajnit të aplikuar, dizajnimin e aplikacioneve web.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që përfundojnë studimet në këtë program studimi kanë mundësi të punësohen në të gjithë sektorët ku përdoret teknologjia kompjuterike, përfshirë përpunimin informacionit dhe proceset operacionale, kompanitë e zhvillimit të softuerit, kompanitë e zhvillimit të produkteve harduerike dhe softuerike, etj. Mbajtësi i diplomës së këtij programi ka mundësi punësimi në pozicionet e mëposhtme:

- Specialist i sistemeve IT
- Specialist i rrjeteve kompjuterike
- Specialist i bazës së të dhënave,
- Zhvillues softuerësh (frontend, backend, mobile, desktop, etj.)
- Dizenjues softuerësh
- Specialist në menaxhimin e projekteve IT

Studentët mund të punësohen në sektorin e biznesit, financiar, të institucioneve publike, OJF, shëndetësore, arsimore etj.



BACHELOR "TEKNOLOGJI INFORMACIONI" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem.	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	------	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/36 ECTS

1	I	1	Algjebër dhe gjeometri	6
2	I	1	Analizë matematike 1	6
3	I	2	Fizikë 2	6
4	I	2	Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi	8
5	I	1	Bazat e Informatikës	4
6	I	2	Hyrje në probabilitet	6

36

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/91 ECTS

1	I	1	Algoritmikë dhe Hyrje në Programim	6
2	I	1	Arkitektura dhe organizimi i kompjuterit	6
3	I	2	Programim 1	6
4	II	2	Programim 2	6
5	II	2	Rrjeta Kompjuterike	6
6	II	1	Strukturë të Dhënash	6
7	II	1	Teori e Bazave të të Dhënave	6
8	II	2	Sistemet e operimit	6
9	II	2	Sisteme informacioni në menaxhim	6
10	III	1	Komunikim të dhënash	6
11	III	1	Virtualizimi dhe Cloud Computing	5
12	III	1	Hyrje në Big Data dhe inteligjencën e biznesit	8
13	III	1	Sistemet e Informacionit dhe Siguria	6
14	III	2	Hyrje ne Inxhinieri Softwerike	6
15	III	2	Administrim sistemesh kompjuterike	6

91

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/24 ECTS

PROFILI II- Hartim Softwere				
1	II	1	E-Shërbimet	6
2	II	2	Web development	6
3	III	2	Machine learning	6
4	III	1	Zhvillimet e aplikacioneve mobile	6
5	III	1	Honors Course	6
PROFILI III- Grafikë - Dizajn				
1	II	1	Kompozim pamor	6
2	II	2	Programet e dizajnit	6
3	III	1	Dizajn për Web dhe Aplikacione	6
4	III	2	Zhvillim Stili Personal	6
5	III	1	Honors Course	6

24

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/18 ECTS

1	II	1	Anglisht	5
2	II	1	Bazat e multimedias	6
4	I	2	Hartim dhe menaxhim projekte	6
3	III	2	Praktikë profesionale dhe zhvillim studenti	5

22

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---